

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të burgosurve në Shqipëri

KURRIKULA PËR TRAJNIMIN E STAFIT TË INSTITUCIONEVE PENITENCIARE PËR TË MITUR

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë tekst janë të autorëve dhe nuk përfshijnë përgjegjësinë e Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës

Kurrikula per trajnimin e stafit te institucioneve penitenciare per te mitur është përgatitur në bashkëpunim me një grup pune nga stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Administratës së Burgjeve të Shqipërisë, në kuadrin e Projektit "Horizontal Facility" të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë - Veprimi për "Forcimin e Mbrojtjes të së Drejtave të Njeriut të të Burgosurve në Shqipëri"

Hartimi i Kurrikulës: Kurrikula e trajnimit të stafit të personelit penenciar për të miturit

Kjo kurrikulë është një përpjekje për të komunikuar parimet dhe veçoritë thelbësore të programit në një formë të atillë që jetë e hapur për shqyrtim kritik dhe të jetë në gjendje të zbatohet në praktikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPBSh) Misioni dhe Vizioni

Krijimi i kushteve të përshtatshme për zbatimin rigoroz të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor duke siguruar që të gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit ofrojnë trajtim njerëzor të personave me liri të kufizuar dhe transformimin e drejtësisë penale në një mundësi ri-edukimi.

- Të zhvillojë një strategji të përshtatshme për sistemin e burgjeve dhe kushtet sociale në Shqipëri.
- Të zhvillojë programe të specializuara për të rritur punësimin e të burgosurve për secilin burg duke patur parasysh kushtet e secilit institucion.
- Të fuqizojë sistemin e burgjeve dhe rritjen profesionale të stafit, duke i motivuar ata që të kryejnë një shërbim më të mirë, që do të rriste sigurinë në shoqëri dhe do të kishte efekte pozitive tek mirëqenia e institucionit.

Synimet, objektivat dhe rezultatet e nxënies të përditësuar nga:

- Ligji 8328 për të Drejtat dhe Trajtimin e të Burgosurve dhe të Paraburgosurve¹;
- Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve;
- Standardet e Këshillit të Evropës (rekomandimet Rec (2006) 2 për Rregullat Evropiane të Burgjeve; Rekomandimi Rec (97) 12 për stafin i cili bën zbatimin e sanksioneve dhe masave; Rekomandimi CM/Rec (2012) 5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare në lidhje me Kodin Evropian të Etikës për Stafin e Burgjeve dhe Standardet e KPT-së);

¹(Amenduar nga Ligji Nr. 8758, i datës 26.3.2001 botuar në OB nr. 15)
(Amenduar nga Ligji Nr. 9071, i datës 22.5.2003 botuar në OB nr. 53)
(Amenduar nga Ligji Nr. 9888, i datës 10.3.2008 botuar në OB nr. 44)
(Amenduar nga Ligji Nr. 10 087, i datës 26.2.2009 botuar në OB nr. 32)
(Amenduar nga Ligji Nr. 40/2014, i datës 17.4.2014, botuar në OB nr. 67)

- Rekomandimi CM/Rec(2008) 11 i Komitetit të Ministrave të Keshillit të Evropës për Shtetet anëtare mbi Rregullat Evropiane për të denuarit e mitur që janë subjekt i sanksioneve dhe masave;
- Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë Penale për të Mitur ("Rregullat e Pekinit");
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

Rregullorja për trajnimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 2. Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të unifikojë aktivitetin e Drejtorisë së Burgjeve në fushën e trajnimit policor dhe civil, në kontekstin e përmbushjes së përgjegjësive dhe progresit në karrierë të efektivëve të policisë dhe atyre civilë.

Neni 9 Të gjithë trajnimet ... mbahen bazuar në kurrikulë. Kurrikula përgatitet dhe zhvillohet nga specialistë të sektorit të trajnimit në bashkëpunim me specialistë nga sektori i trajnimit në bashkëpunim me specialistë nga sektorë të ndryshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Hyrje tek përshkrimi i modulit

Një modul është një njësi mësimore më vete. Modulet mund të ndiqen dhe të vlerësohen vetëm ose në lidhje me module të tjera. Këto përshkrime të modulit, përshkruajnë:

- Qëllimin dhe objektivin e modulit; dhe
- njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që studentët e suksesshëm do të arrijnë në përfundim të modulit; dhe

Qëllimi i këtij përshkrimi të modulit është të:

- Japë udhëzime të qarta për trajnimin e stafit duke i ndihmuara ata në planifikimin e programeve; dhe
- Sigurojë një sistem vlerësimi i cili i mundëson pjesëmarrësve që të demonstrojnë arritjet e tyre.

Përmbajtja e përgjithshme e moduleve dhe metodat e ofrimit të tyre duhet të planifikohet nga stafit trajnues. Kurrikula trajnuese për stafin e personelit të institucionit penitenciar në lidhje me të miturit synon rritjen e kapaciteteve profesionale dhe personale për të përmbushur objektivat e trajtimit, mbështetjes dhe rehabilitimit të të dënuarve të mitur dhe atyre që janë në pritje të gjyqimit. Stafi i personelit të institucionit penitenciar duhet të kryejë detyrën me standardet më të larta profesionale dhe personale. Për të arritur këtë, drejtuesit e burgjeve do të sigurojnë se gjatë gjithë karrierës së tyre, i gjithë stafi duhet të mirëmbajë dhe përmirësojë njohuritë dhe dijet tyre profesionale duke

marrë pjesë në kurse që shërbejnë për trajnim dhe zhvillim. Trajnimi i të gjithë stafit duhet të përfshijë standarte dhe udhëzime për të drejtat ndërkombëtare dhe rajonale të njeriut dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Përveç temave kryesore, kurrikula rishikohet dhe përditësohet rregullisht me informacion të ri, të tilla si mendimet e ligjeve të drejtësisë penale për të mitur dhe rekomandimet e organizatave të pavarura monitoruese të burgjeve dhe institucioneve të paraburgimit. Gjatë trajnimit, kurrikula do të përmirësohet dhe përshtatet sipas nevojave të stafit dhe performancës së institucionit.

. Metoda më e përshtatshme për ri-fokusimin në kurrikulë duhet të përqendrohet tek:

- (1) rritjen e ndërgjegjësimit të stafit penitenciar për rëndësinë e rolit të tyre në ndihmesën e riintegrit të të miturve;
- (2) fuqizimi i stafit për të ndërmarrë përgjegjësi për të gjitha veprimet e tyre në mënyrë që të arrijnë standardet profesionale të kryerjes së detyrës;
- (3) riformulimi i programimit trajnues dhe modifikimi i materialit ekzistues të trajnimit;
- (4) rritja e theksit tek mësimi aktiv dhe inskenimi me rol, duke përdorur aftësitë ndër-personale;
- (5) rritja e theksit tek fakti se si ndikojnë tek të tjerët veprimet e stafit;
- (6) dhënia e vetë-motivimit për t'u siguruar që stafi vazhdimisht mban lart standardet dhe idealet e mësuara gjatë trajnimit fillestar;
- (7) thelbi i qasjes profesionale në rolin e stafit të burgjeve është mundësia për të komunikuar dhe për këtë qëllim çdo temë duhet të përmbajë elementë ku theksohen aftësitë ndër-personale.

Së fundi, objektivi parësor duhet të jetë krijimi i një manuali si për trajnuesit ashtu edhe për të trajnuarit. Të trajnuarit duhet të kryejnë trajnimin fillestar me një paketë të përbërë prej materiale me shkrim të cilave i referohen në rastet e nevojshme gjatë kryerjes së detyrave në vendin e punës. Seancat / kurset pasuese të trajnimit mund të përshtaten si pjesë përbërëse e këtyre manualeve duke krijuar një burim referimi të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës i cili mund të pasqyrojë aspektet e ndryshme me interes gjatë kohës të progresit që ata kanë gjatë shërbimit.

Për trajnuesit, manuali përmban prezantime me diapozitivë, tabela, broshura dhe një udhëzues se si të prezantojnë çdo sesion. Ky udhëzim përfshin një vështrim të përgjithshëm të temës me informacione shtesë të historikut, objektiva për çdo sesion dhe rezultatet specifike për mësimet që merr çdo pjesëmarrës, strukturën e çdo sesioni dhe kohëzgjatjen.

Është e qartë që këto objektiva nuk do të arrihen në terma afatshkurtër; megjithatë, nëse fillojmë kursin tjetër duke pasur parasysh këto objektiva, ky do të ishte një fillim i mbarë.

Metoda e Mësimdhënies

Metodat e mësimdhënies dhe nxënies: Varet nga modulet/sesioni: Përfshijnë: - leksione, detyra, metoda nxënieje bazuar në përvojë, metoda të nxënies me anë të pjesëmarrjes, demonstrime praktike, inskenime, dëgjimi i mendimeve, simulime, diskutime dhe refleksione.

Metodat e të nxënit për të rritur, parimet e Andragogjisë, pranojnë faktin se të rriturit duhet të dinë arsyen se pse duhet të mësojnë diçka². Kështu që, trajnuesit duhet ta shpjegojnë qartë:

- Arsyen e trajnimit;
- Si do të përfitojnë ata; dhe
- Si do të përfitojnë të tjerët.

Të rriturit duhet të jenë partnerë në planet dhe vlerësimet e tyre arsimore.

Materiali duhet të jetë i përshtatshëm.

Mësimi i bazuar në zgjidhjen e problemit është më i efektshëm se mësimi i bazuar në përmbajtje.

Fokusi i moduleve është tek “Mësimi” dhe jo tek “Trajnimi”.

Mjetet ndihmëse

Varet nga modulet/sesioni. Mjetet ndihmëse të mësimdhënies përfshijnë prezantimet me diapozitivë, prezantimet me projektorë, përdorimi i tabelave dhe pajisjeve të ndryshme të përshtatshme për sesione të veçanta.

Vlerësimi i të nxënit

Varet nga modulet/sesioni. Studentët vlerësohen nga një provim i strukturuar i mbikëqyrur, detyra, pjesëmarrje, demonstrimi i kompetencave të pritshme apo vlerësimi praktik.

Vlerësimi.

Rekomandohet që të përdoret ‘Modeli Vlerësues për Trajnime i Kirkpatrick me Katër Nivele³’ për vlerësimin e efektshmërisë së këtij programi. Përgjegjësia për vlerësimin afatgjatë i takon Qendrës së Trajnimeve/Njësisë së Trajnimeve.

Niveli 1 i Vlerësimit: Reagimi – Masa në të cilën pjesëmarrësit e gjejnë trajnimin si të dobishëm, angazhues dhe të përshtatshëm për punën e tyre.

Niveli 2 i Vlerësimit: Nxënia – Masa në të cilën pjesëmarrësit kërkojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimin, vetëbesimin dhe përkushtimin e synuar gjatë pjesëmarrjes së tyre në trajnim.

Niveli 3 i Vlerësimit: Sjellja – Masa në të cilën pjesëmarrësit zbatojnë në praktikë atë që kanë mësuar gjatë trajnimit kur kthehen në vendin e tyre të punës.

² Malcolm Knowles Knowles, M. (1984). Andragogjia në Veprim. San Francisco: Jossey-Bass.

³Donald Kirkpatrick, (1994) Evaluating Training Programs.

Niveli 4 i Vlerësimit: Rezultatet – Masa në të cilën arrihen rezultatet e synuara si pasojë e trajnimit dhe materialit të tij mbështetës.

Nr. i Modullit	TITULLI I MODULLIT	Kapaciteti
	Kurrikula trajnuese për stafin e personelit të institucioneve penitenciare në lidhje me të miturit	40 Orë
Qëllimi: Qëllimi i këtij programi është sigurimi i një baze të Parimeve të Drejtësisë Penale për të Miturit për të gjithë stafin që punon me të miturit.		
Objektivi: Objektivat e këtij programi janë: <ul style="list-style-type: none"> • Të asistojë të gjithë stafin në zbatimin praktik të përditshëm të atyre gjërave që kanë mësuar për parimet e drejtësisë penale të të miturve; dhe • Të asistojë stafin që të punojnë në ekipe shumë disiplinore dhe të kuptojnë rolet e tyre. 		
Synimet: <ul style="list-style-type: none"> • Të japë siguri për stafin dhe të miturit duke mirëmbajtur dhe promovuar qëndrueshmëri në krijimin e një kuadri të menaxhimit të të drejtave të njeriut; • Të sigurojë një mjedis i cili mundëson ndryshime të sjelljes duke vënë në dispozicion mundësi rehabilituese për të miturit të cilët demonstrojnë motivim për ndryshim; • Të sigurojë mirëqenien bazë të të miturve duke i garantuar një kuadër të menaxhimit të të drejtave të njeriut; dhe • Të sigurojë që të gjithë anëtarët e stafit janë përgjegjës për t'i ndihmuar të miturit për nevojat që kanë, si edhe t'i ndihmojnë ata për të bërë ndryshime pozitive në jetën e tyre. 		
Trajneri		
Kurset që lidhen		
Leximet para kursit	Pjesëmarrësve do t'i jepet manuali paraprak për t'u lexuar përpara kursit, të paktën një javë para se të fillojë kursi. Të gjithë pjesëmarrësit duhet të sjellin në trajnim pyetësoin e plotësuar i cili gjendet tek manuali.	

Lënda	Rezultati i mësimit	Subjektet e modulit, nën-subjektet dhe kapaciteti	Metodat e vlerësimit dhe detyrat vlerësuese (plotësohet nga njësia trajnuese)	Metodat e mësimit
1 Hyrje në Sistemin e Drejtësisë për të Mitur (4 orë)	Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojnë parimet e Sistemit të së Drejtës të të Miturve; • Rendisë standardet e të Konventës së të Drejtave të Fëmijës (KDF-ja); • Bëjë një përmbledhje të legjislacionit përkatës; dhe • Shpjegojë rolin e policisë, gjykatave, prokurorëve, sprovës dhe burgjeve në Sistemin e Drejtësisë së Fëmijëve. 	1.1 Hyrje 1.2 Vështrim i Përgjithshëm i Sistemit të Drejtësisë të të Miturve 1.3 Termi drejtësia e të miturve 1.4 Standardet e parapara nga KDF-ja dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare. 1.5 Legjislacioni dhe praktika në vendin tonë.		Njohuri/leksione dhe diskutime
2. instrumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë të të miturve (4 orë)	Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Rendisin instrumentet kryesore ndërkombëtare në lidhje me paraburgimin e të miturve; dhe • Rendisin parimet kyçe të instrumenteve ndërkombëtare. 	2.1 Hyrje 2.2 Instrumentet kryesore ndërkombëtare 2.3 KDF-ja 2.4 Karakteristikat e Përgjithshme të Konventës 2.5 Parimet Kyçe 2.6 Komentet për përmbajtjen e Konventës 2.7 Diskutime dhe ushtrime për zbatimin e tyre		Njohuri/leksione dhe diskutime Ushtrime
3. Standardet e kujdesit në burgim, kujdesi pasues dhe	Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:	3.1 Të drejtat e të miturve të burgosur	-	Njohuri/leksione dhe diskutime

ri-integrimit (4 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Rendisin të drejtat e të miturve; • Shpjegojnë parimet e Programit 4 “Radha Juaj”; dhe • Japin një shpjegim për vizionin strategjik të DPBSh-së për mbrojtjen e fëmijëve. 	<p>3.2 Menaxhimi i institucioneve penale të të miturve</p> <p>3.3 Kujdesi dhe ri-integrimi</p> <p>3.4 Filozofia e programit “Radha Juaj”</p> <p>3.5 Strategjia afatmesme dhe ajo afatgjatë e DPBSh-së për mbrojtjen e fëmijëve</p> <p>3.6 Ushtrime</p>		Ushtrime
4. Komunikimi (4 Orë)	<p>Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstrjnë aftësitë e nevojshme të komunikimit gjatë punës me fëmijët; dhe • Shpjegojnë rëndësinë e kontaktit familjar për të miturit në paraburgim. 	<p>4.1 Aftësitë dhe mundësitë e komunikimit me fëmijët.</p> <p>4.2 Si t’i përfshijmë fëmijët në proces.</p> <p>4.3 Teknikat e komunikimit.</p> <p>4.4 Nxitja e kontaktit me familjen, shokët/shoqet dhe kushërinjtë.</p> <p>4.5 Ushtrime dhe diskutime.</p>		<p>Njohuri dhe Aftësi</p> <p>Leksione dhe diskutim</p> <p>Ushtrime</p> <p>Inskenime me role</p>
5. Parimet e punës me fëmijët dhe adoleshentët brenda sistemit penal (4 Orë)	<p>Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojnë ‘aftësinë rikuperuese’; dhe • Demonstrjnë se kanë kuptuar aftësitë që nevojiten për promovimin e mirëqenies psikologjike të fëmijëve. 	<p>5.1 Hyrje</p> <p>5.2 Psikologjia e Fëmijëve & Adoleshentëve</p> <p>5.3 Promovimi i ‘aftësisë rikuperuese’.</p> <p>5.4 Aftësitë për të promovuar mirëqenien psikologjike të fëmijëve.</p>		Njohuri/leksione dhe diskutime Ushtrime / Raste Studimore
6. Praktika e punës në grup me fëmijët që janë në shkelje të ligjit (4 Orë)	<p>Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Demonstrjnë aftësitë e 	<p>6.1 Hyrje</p> <p>6.2 Parimet filozofike të punës në grup me fëmijët dhe</p>		Njohuri / Aftësi Leksion dhe diskutim Ushtrime/Raste

	<p>punës në grup;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Japin një shpjegim për parimet filozofike të punës në grup; dhe • Demonstrjnë parimet që përforcojnë teknikat motivuese të intervistimit. 	<p>vlerat që duhen respektuar në punën me fëmijët.</p> <p>6.3 Praktikimi i punës në grup me fëmijët, objektivat e punës dhe shembuj ilustrues.</p> <p>6.4 Intervistat motivuese.</p>		studimore
7. Puna individuale – teknikat dhe metodat e punës me fëmijët që janë në shkelje të ligjit. (4 Orë)	<p>Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojnë procesin këshillues; dhe • Demonstrjnë se kanë kuptuar kriteret e nevojshme për të zgjidhur mospërputhjet dhe mesazhet jo të qarta. 	<p>7.1 Hyrje</p> <p>7.2 Procesi i këshillimit</p> <p>7.3 Identifikimi i pikave të forta dhe mbështetja për to në punën me fëmijët.</p> <p>7.4 Puna drejt zgjidhjes së mospërputhjeve dhe mesazheve jo të qarta.</p>		Njohuri/leksione dhe diskutime Ushtrime/Raste studimore
8. Teknikat e përfshirjes së fëmijëve (4 Orë)	<p>Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rendisin kategoritë e 'nevojave speciale' të të miturve; • Shpjegojnë rolin e stafit në një qendër paraburgimi për të miturit; dhe • Shpjegojnë se çfarë nënkuptohet me procedurat 'miqësore me fëmijët'. 	<p>8.1 Hyrje</p> <p>8.2 Procedurat miqësore të përfshirjes së fëmijëve</p> <p>8.3 Roli i të punësuarve në institucionet penitenciare.</p> <p>8.4 Fëmijët me nevoja të veçanta.</p>		Njohuri/leksione dhe diskutime Ushtrime/Raste studimore / inskenime me role
9. Një klimë e sigurtë për ndërhyrjen terapeutike	<p>Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:</p>	<p>9.1 Modelet e aftësive sociale</p> <p>9.2 Zhvillimi i aftësive që kanë</p>		Njohuri/leksione dhe diskutime

<p>(4 Orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rendisin procesin e zhvillimit të aftësive të jetës tek të miturit; dhe • Demonstrojnë një qasje pro-sociale për të punuar me të miturit. 	<p>të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ritmin e ditës dhe natës dhe kujdesin për veten; - Ngrënien së bashku me personat e tjerë; - Pastrimi i dhomës dhe ambienteve të tjera; - Punët e përditshme të shtëpisë; - Kontaktet me eprorët; - Kontaktet me anëtarët e grupit; - Përballjen me tensione, etj; dhe <p>9.3 Vlerat e moralit dhe ato standarte.</p>		<p>Ushtrime/Raste studimore</p>
<p>10. Vlerësimi i riskut dhe faktorët e mbrojtjes për trajtimin e të miturve në institucionet penale.</p> <p>(4 Orë)</p>	<p>Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plotësojnë një formular të vlerësimit të riskut; • Shpjegojnë parimet e drejtësisë restorative; dhe • Shpjegojnë rolin e stafit të burgut që bashkëpunon me agjencitë e jashtme. 	<p>10.1 Faktorët e riskut për recidivizmin.</p> <p>10.2 Modeli për këshillimit dhe vlerësimin e të miturve.</p> <p>10.3 Politikat për uljen e kriminalitetit tek të rinjtë.</p> <p>10.4 Zhvillimi i programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit.</p> <p>10.5 Bashkëpunimi me partnerët e tjerë jashtë sistemit.</p> <p>10.6 Drejtësia restorative.</p> <p>10.7 Diskutim.</p>		<p>Njohuri/leksione dhe diskutime</p> <p>Ushtrime/Raste studimore</p>
<p>11. Siguria, Rendi i Mirë dhe Disiplina</p>	<p>Në fund të kësaj teme, studentët</p>	<p>11.1 Rekomandimi CM/Rec(2008) 11 dhe</p>	<p>Kryerja e një kontrolli të inskenuar</p>	<p>Njohuri dhe Aftësi</p>

(? Orë)	<p>do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojnë dhe rendisin parimet kryesore të rekomandimit të KIE (2008) 11 dhe Standardet e KPT-në që kanë të bëjnë me të miturit; • Demonstrjnë teknikat e qetësimit të agresionit dhe zemërimit; • Shpjegojnë rëndësinë e sigurisë dinamike; • Demonstrjnë aftësitë e dhënies së shembullit pro social; • Rendisin llojet e të burgosurve të cënueshëm; dhe • Plotësojnë formularin e vlerësimit të riskut dhe nevojave. 	<p>Standardet e KPT-së që kanë të bëjnë me të miturit.</p> <p>11.2 Parimet e:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kontrollit -Përdorimit të forcës, kufizim fizik dhe armët -Veçimin për arsye të sigurisë dhe rendit - Disiplina dhe ndëshkimi <p>11.3 Siguria dinamike</p> <p>11.4 Dhënia e shembullit pro-social</p> <p>11.5 Menaxhimi i incidenteve të dhunshme (veçanërisht qetësimin e situatës në mënyrë verbale për të ulur tensionet dhe teknikat profesionale të kufizimit)</p> <p>11.6 Të miturit e cënueshëm dhe parandalimi i viktimizimit. Treguesit e bullizmit dhe qasja pro-aktive e përshtatshme për parandalimin e tij</p> <p>11.7 Vlerësimi i riskut për sigurinë dhe rendin</p>	<p>Angazhimi në inskenimin e një roli për hapat e qetësimit të situatës për të ulur tensionet.</p>	<p>Leksione dhe diskutime Ushtime Inskenime me role</p>
12. Kujdesi shëndetësor (? orë)	Në fund të kësaj teme, studentët do të jenë në gjendje të:	12.1 Parimet e kujdesit shëndetësor (aksesi tek mjeku,		Njohuri dhe Aftësi

	<ul style="list-style-type: none"> • Rendisin parimet e kujdesit shëndetësor në burgje; • Rendisin sjelljet e zakonshme të rrezikshme të të miturve; • Demonstron aftësitë në trajtimin e incidenteve të vetëlëndimit; • Shpjegojnë problemet kryesore të shëndetit mendor; dhe • Shpjegojnë kuptimin e mirëqenien e shëndetit mendor. 	<p>kujdesi i duhur; pëlqimi dhe konfidencialiteti i pacientit; kujdesi shëndetësor parandalues; pavarësia profesionale dhe kompetenca profesionale)</p> <p>12.2 Nevojat e veçanta mjekësore të të miturve të privuar nga liria.</p> <p>12.3 Problemet shëndetësore (psh. Varësia ndaj drogës, abuzimi seksual dhe prirjet për vetëvrasje).</p> <p>12.4 Sjelljet e rrezikshme (droga, alkoli dhe praktikat seksuale)</p> <p>12.5 Vetëdijësimi i shëndetit mendor</p> <p>12.6 Parandalimi i vetëvrasjes dhe vetëlëndimit</p> <p>12.7 Menaxhimi i abuzimit me substancat</p> <p>12.8 Sëmundjet e transmetueshme</p>		<p>Leksion dhe diskutim Ushtrime Inskenim me role</p>
Puna individuale në modul	Pjesëmarrësve i kërkohet që të lexojnë materialin paraprak të kursit përpara fillimit të kursit. Gjatë gjithë programit do të			

	inkurajohen praktikat reflektive.
Përbërja e krediteve të modulit	Metoda e vlerësimit për modulin është një vlerësim jo dallues.
Literatura /materialet e përdorur për mësim	<p>BURIMET E DETYRUESHME:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji 8328 për të Drejtat dhe Trajtimin e të Burgosurve dhe të Paraburgosurve • Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve • Kodi i Etikës së DPBSh-së për Stafin e Burgut • Standardet e Këshillit të Evropës (Rregullat Evropiane të Burgjeve [Rec 2006:2], Trajnimi i Personalit [Rec 97:12], Kodi i Etikës për Stafin e Burgut [Rec 2012:5] dhe Standardet e KPT-së); • Rekomandimi CM/Rec(2008) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Shtetet anëtare mbi Rregullat Evropiane për të denuarit e mitur që janë subjekt i sanksioneve dhe masave; • Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë Penale për të Mitur (“Rregullat e Pekinit”); • Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës <p>BURIMET E REKOMANDUARA</p>
Kurset pasuese	<p>Ky kurs themeltar konsiderohet si një kurs prezantues për të të gjithë stafin që punon me të miturit. Kurset vijuese të veçanta do të sigurojnë një studim më të thellë të temave në këtë program dhe kurse shtesë për:</p> <p>Stafin e sigurisë Stafin punues edukativ dhe social Stafin e kujdesit shëndetësor</p> <p>(hollësitë e kursit do të shtohen nga Njësia Trajnuese/Qendra e Trajnimit)</p>